



PAX
Association

THE BALKAN TRUST FOR DEMOCRACY

PUSHTETI LOKAL NE
SHERBIM TE QYTETAREVE

Rezultatet e anketës
me qytetarë



Ulcinj, 2004

titulli i projektit:
PUSHTETI LOKAL NE SHËRBIM TE QYTETARËVE

realizues:
OJQ "Horizonti i ri"
Ulqin
tel: 085/401-080
fax: 085/411-969
cel: 067/300-603
e-mail: horizon@cg.yu

partner në projekt:
Qendra për marrëdhënie ndëretnike dhe të drejta të pakicave - PAX
Ulqin
tel: 085/411-654
cel. 067/234-727
E-mail: pax@cg.yu

GRUPI PUNUES:

Nazif Veliqi
Xhemal Peroviq
Ardita Rama
Nazif Cungu
Zana Sarvan
Qazim Muja
Mustaf Canka

përpunimi dhe paraqitja grafike
OJQ "Horizonti i ri"

shtypi:
PRESS STUDIO - Ulqin

donator
THE BALKAN TRUST FOR DEMOCRACY

SHËNIME HYRËSE

ANKETA ME QYTETARË është faza e dytë e projektit “Pushteti lokal në shërbim të qytetarëve” të cilin e realizojnë organizatat joqeveritare “Horizonti i ri” dhe Pax”, me mbështetjen e fondacionit The Balkan Trust for Democracy. Ky është viti i dytë me radhë që këto dy asociacione monitorojnë punën e administratës lokale, procesin e realizimit të reformave si dhe zbatimit të ligjeve.

Qëllimet e anketës që realizuam këtë vit ishin:

- përcaktimi i nivelit të (jo)efikasitetit të pushtetit lokal në raport me nevojat e qytetarëve si dhe i shkallës së (pa)kënaqësisë së qytetarëve pas kontaktimit me shërbimet e Komunës
- rritja e shkallës së përgjegjësisë së zyrtarëve të administratës lokale
- dhënia e rekomandimeve për funksionim më të mirë të administratës lokale

Anketimi i qytetarëve është zhvilluar nga 21 – 25 qershor 2004.

Procesi i anketimit të qytetarëve është zhvilluar paralelisht në dy drejtime: para ndërtesës së Komunës dhe në teren me kalimtarë të rastit (në pjesët urbane dhe rurale të Ulqinit).

Anketa ka qenë e ndërtuar nga dy pyetësorë të veçantë: njëri për qytetarët të cilët kontaktojnë administratën lokale, i cili ka pasur vetëm 3 pyetje dhe tjetri për qytetarët tjerë – kalimtarë të rastit me 20 pyetje.

Në pyetësorin e parë janë përgjigjur 285 qytetarë pasi kishin kontaktuar administratën e Komunës, ndërsa me pyetësorin e dytë kemi anketuar gjithsej 450 qytetarë në pjesë të ndryshme të qytetit dhe në Anë të Malit.

I gjithë materiali i anketimit ka qenë në dy gjuhë (shqipe dhe malazeze) në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe përvojën pozitive nga mjediset shumetnike.

Gjatë këtyre pesë ditëve në shërbim të qytetarëve kemi vënë edhe një numër të veçantë telefonik (401-082) në të cilin ata kanë mundur të paraqesin ankesat, vërejtjet si dhe lavdërimet e veta për punën e pushtetit lokal.

Për të rritur efikasitetin e punës tonë dhe për të mënjeluar mangësitë që kemi vërejtur në anketën e parë (2003), në procesin e hartimit të pyetësorëve dhe të strategjisë së përgjithshme për realizimin e anketës, është ngritur një grup i gjerë punues me përfaqësues nga qeverisja lokale, sektori i biznesit, kultura, medias dhe të sektorit joqeveritar.


Gjithashtu për një realizim sa më të suksesshëm të kësaj veprimtarie janë trajnuar dhe angazhuar grupi prej 10 vullnetarësh.

Përgjigjet e qytetarëve duke dalë nga Komuna

Tabela 1: Si kryhen punët në komunë?

<i>Kur keni punë në komunë, i kryeni ato:</i>	Të anketuar 2004	% 2004	% 2003
Shpejt	72	25%	23%
Pritni shumë	164	58%	62%
Pritje e arsyeshme	49	17%	15%

285




- * Qytetarët i kryejnë punët në Komunë pak më shpejt (2%) se vitin e kaluar
- * Qytetarët këtë vit pritën më pak (për 4%) për të kryer punët e veta
- * Pak më shumë qytetarë pritjen për të kryer punë e konsiderojnë të arsyeshme

Tabela 2: A mund të kryhen më shpejt punët në komunë?

<i>Punët në komunë a mund të kryhen më shpejt ?</i>	Të anketuar 2004	% 2004	% 2003
Po	219	77%	52%
Jo	37	13%	37%
Nuk e di	29	10%	11%

285




Më shumë qytetarë (se në 2003) mendojnë se punët në Komunë mund të kryhen më shpejt

Tabela 3: Si ndahen qytetarët nga komuna?

<i>Po sot, jeni ndarë:</i>	Të anketuar 2004	% 2004	% 2003
Të kënaqur	139	49%	47%
Të pakënaqur	89	31%	27%
Nervoz dhe të revoltuar	57	20%	26%

285



* Gjatë kohëzgjatjes së anketimit gati gjysma e të anketuarëve u ndanë të kënaqur (e që është pak më shumë se vitin e kaluar)


* Ndërsa të pakënaqur e të revoltuar dolën pothuajse po aq qytetarë sa edhe vitin e kaluar

ANKETA ME QYTETARË në terren

Pyetja nr 1. Cilin institucion qytetarët e Ulqinit kontaktojnë më shumë?

<i>Me cilin prej ketyre instituc. keni më shumë kontakt Me:</i>	Të anketuar 2004	% 2004	% 2003
Shtëpinë e Shëndetit	158	35%	21%
Policinë	46	10%	14%
Komunën	178	41%	28%
Gjykatën	28	6%	11%
Askund	15	3%	
Tjetër	24	5%	12%

449




Komuna vazhdon të jetë institucioni që më së shumti kontaktohet

Pyetja nr 2: Ku bëhet më shumë padrejtësi?

<i>Ku ju është bërë më shumë padrejtësi ? Në:</i>	Të anketuar 2004	% 2004	% 2003
Gjykatë	83	18%	13%
Shtëpi të shëndetit	51	11%	9%
Komunë	173	40%	50%
Polici	56	12%	16%
Askund	39	9%	
Tjetër	47	10%	

449




Në Komunë qytetarëve iu bëhet më së tepërmi padrejtësi (por më pak se vitin e kaluar)

Pytja nr 3: Qytetarët vlerësojnë punën e drejtuesëve të pushtetit lokal?

<i>Si e vlerësoni punën e drejtuesëve të pushtetit lokal ?</i>	Të anketuar 2004	% 2004	% 2003
1	214	48%	56%
2	119	26%	19%
3	75	17%	16%
4	22	5%	3%
5	20	4%	6%

450




Gati gjysma e të anketuarëve (48%) punën e drejtuesëve të pushtetit lokal e vlerësojnë me notë të dobët.

Pyetja nr. 4. Si e vlerësojnë qytetarët e Ulqinit punën e Kryetarit të Komunës?

<i>Si e vlerësoni punën e Kryetarit të Komunës</i>	Të anketuar 2004	% 2004
1	226	51%
2	90	20%
3	77	17%
4	29	6%
5	28	6%

450



Për herë të parë në Ulqin vlerësohet puna e Kryetarit të Komunës. Më shumë se gjysma e të anketuarëve – 51% Kryetarit i dhanë notë të dobët (nga 1 – 5).

Pyetja nr 5. Sa kanë informata qytetarët për punët që kryhen në Komunë?

A keni informata të mjaftueshme për shërbimet dhe punët që kryhen në komunë ?	Të anketuar 2004	% 2004
Po	154	34%
Jo	296	66%

450




Dy të tretat e qytetarëve nuk kanë informata të mjaftueshme për punët dhe shërbimet që kryhen në Komunë

Pyetja nr. 6. Qytetarët vështirë gjejnë zyrën që kërkojnë?

Kur keni punë në komunë, a e dini fillimisht se ku të drejtoheni?	Të anketuar 2004	% 2004
Po	209	46%
Jo	241	54%

450




Më shumë se gjysma e qytetarëve – 54% nuk dinë të gjejnë shërbimin, zyrën ose personin përgjegjës kur hyjnë në ndërtesën e Komunës

Pyetja nr 7. A dinë qytetarët se në Komunë ekziston një qendër informative që është në shërbim të tyre?

A dini se në Komunë ekziston një qendër (zyrë) për informimin e qytetarëve mbi punën e vetëqeverisjes lokale?	Të anketuar 2004	% 2004
Po	115	26%
Jo	335	74%

450




74 % e qytetarëve nuk dinë aspak se në Komunë ekziston QEI (e cila ka për qëllim informimin e qytetarëve mbi punën e vetëqeverisjes lokale

Pyetja nr 8. Sa ka transparencë në punën e pushtetit lokal ?

Sa është publike (transparente) puna e pushtetit lokal?	Të anketuar 2004	% 2004
Shumë	20	4%
Pak	140	31%
Fare pak	101	22%
Aspak	189	43%

450




Vetëm 4% e qytetarëve të anketuar vlerësojnë se puna e pushtetit lokal është shumë transparente. Mungesa e transparencës ndaj qytetarëve është evidente.

Pyetja nr 9. Çështjet për të cilat qytetarët dëshirojnë që Komuna t'i pyes (në referendum)?

<i>Për cilën çështje do të dëshironit që Komuna të marrë pëlqimin tuaj (në referendum)? Për:</i>	Të anketuar 2004	% 2004
Infrastrukturën rrugore	185	41%
Pastërtinë e qytetit	135	30%
Përmirësimin e furnizimit me ujë	82	18%
Për të gjitha (më sipër)	34	8%
Diçka tjetër	14	3%

450

QYTETARËT DUAN TË PYETËN PËR:




Qytetarëve më së shumti i preokupon infrastruktura rrugore (trotualet, parkingu,...) dhe pastërtia e qytetit, por dëshirojnë që Komuna t'i pyes edhe për çështje tjera.

Pyetja nr 10. Gatishmëria e qytetarëve që të japin kontributin e tyre ?

<i>A do të ishit të gatshëm që për këtë çështje të jepni edhe kontributin tuaj?</i>	Të anketuar 2004	% 2004
Po	394	88%
Jo	56	12%

450

QYTETARËT JANË TË GATSHËM TË NDIHMOJNË




Shumica dërmuese e tyre (88%) janë të gatshëm të japin kontributin e vet për këto çështje.

Pyetja nr 11. Ndikimi i qytetarëve në punën e pushtetit lokal.

<i>Ju personalisht, sa keni mundësi ndikimi në punën e pushtetit lokal?</i>	Të anketuar 2004	% 2004
Shumë	35	8%
Pak	116	26%
Fare pak	53	12%
Aspak	246	54%


450



Pyetja nr 12. Ndikimi i OJQ-vë në përmirësimin e punës së pushtetit lokal ?

<i>A mendoni se OJQ-të mund të ndikojnë në përmirësimin e funksionimit të pushtetit lokal?</i>	Të anketuar 2004	% 2004
Po	340	76%
Jo	110	24%

450



Pyetja nr 13. Besueshmëria e qytetarëve ndaj organizatave joqeveritare?

<i>Sa u besoni organizatave joqeveritare?</i>	Të anketuar 2004	% 2004
Shumë	119	26%
Pak	268	60%
Aspak	63	14%

450




Pyetja nr 14. Vlerësimi i punës së organizatave joqeveritare të Ulqinit?

<i>Me cilën notë e vlerësoni punën e organizatave joqeveritare të Ulqinit?</i>	Të anketuar 2004	% 2004
1	55	12%
2	80	18%
3	154	34%
4	85	19%
5	76	17%

Nota mesatare = 3,10


450



Pyetja 15. Gjërat pozitive në punën dyvjeçare të pushtetit lokal?

A ka diçka pozitive në punën dyvjeçare të pushtetit lokal?	Të anketuar 2004	% 2004
Po	117	26%
Jo	333	74%

450




nëse PO, çka?	përgjigjet PO
Pastërtia më e mirë	36
Avancim - përparim i përgjithshëm	26
Rrugët (asfaltim, ndriçim)	18
Përgatitja e sezonit	5

Pyetja nr 16. Çka do ta përmirësonte punën e pushtetit lokal?

Çka mund të ndikojë në përmirësimin e punës së pushtetit lokal ?	Të anketuar 2004	% 2004
Ndryshimet kadrovike	123	27%
Modernizimi i shërbimeve	119	26%
Zgjedhjet e reja	197	45%
tjetër	11	2%


450



Pyetja 17. Pengesat për funksionimin efikas të pushtetit lokal?

Çka e pengon funksionimin efikas të pushtetit lokal?	Të anketuar 2004	% 2004
Rrethanat e përgjithshme në shoqëri	42	9%
Mosmarrëveshjet brenda koalicionit në pushtet	173	38%
Pushteti republikan	46	10%
Interesat personale	180	41%
tjetër	9	2%


450



Pyetja nr 18. Korrupcioni në vetëqeverisjen lokale?

A mendoni se ka korrupcion në vetëqeverisjen lokale?	Të anketuar 2004	% 2004
Po	344	76%
Jo	84	19%
Nuk e di	22	5%


450



Pyetja nr 19. Ballafaqimi i qytetarëve me korrupcionn.

<i>Po ju personalisht, a jeni ndeshur me këtë dukuri?</i>	Të anketuar 2004	% 2004
Po	163	36%
Jo	279	62%
Nuk e di	8	2%

450



Pyetja nr 20. Qytetarët kërkojnë zyrtarin më të suksesshëm të administratës lokale ?

<i>Kush është për ju zyrtari më i suksesshëm i administratës lokale</i>	Të anketuar 2004	% 2004	% 2003
Askush	250	81%	82%
Osman Rexha	20	7%	9%
Zana Sarvan	17	6%	2%
Fuad Nimani	13	4%	6%
Skender Hoxha	8	2%	1%

* pa përgjigje ose "dikush tjetër" (<1%) = 142 të anketuar

308

